



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 71-të të mbajtur më 30.06.2022 ka miratuar sa vijon

#### VENDIM

Procedura në lëndën me numër 12-375/1 nga data 22.01.2021, e formuar pas denoncimit të dorëzuar për personin zyrtar, drejtor dhe persona të punësuar -----  
-----, NDËRPRITET.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për faktin se në lëndën në fjalë veprohet nga organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12 -375 të datës 13.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më datë 22.01.2021 është dorëzuar denoncim për personat zyrtar -----, drejtor në ----- dhe -----  
-----dhe ----- të punësuar në -----  
----- u formua lëndë me numër 12-375/1 të datës 22.01.2021.

pretendimet në denoncim i referohen disa paligjshmëri të kryera nga personat e treguar gjatë lidhjes së kontratave për shitjen e rërës. Nga 1 nëntori 2020 deri në janar 2021, personat abuzuan me pozitën e tyre zyrtare në gjatë lidhjeve të kontratave për shitjen e rërës. Sipas të dhënave të lartpërmendura, personat kanë vepruar në mënyrë të paligjshme në formimin e komisioneve të prokurimit publik, pra në anëtarësimin e tyre – kanë bërë shantazh të mjeteve nga personat juridikë që i kanë favorizuar dhe me të cilët, pas përfundimit të procedurave të prokurimit publik në të cilat të njëjtat persona juridikë ishin pjesëmarrës të vetëm, kontratat janë lidhur me vlerë të përcaktuar paraprakisht. Përveç kësaj, personat kanë kryer shantazh të mjeteve edhe nga personat juridikë me të cilët AD "-----" tashmë kishte lidhur kontrata, pas së cilës personat juridikë u lejuan në mënyrë të vetëdijshme të bëjnë parregullsi në veprimin e

tyre në kryerjen e aktiviteteve kontraktuale. Kërcënimi është kryer edhe gjatë dhënies së lejeve për personat juridikë.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe konstatimit të gjendjes faktike në rastin e raportuar, KSHPK-ja ka dorëzuar kërkesa për mbledhjen e të dhënave dhe informatave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Prokurorinë Themelore Publike Shkup (PTHP Shkup) dhe në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHP NKOK).

Institucionet e cekura kanë dorëzuar informatat e kërkuara në KSHPK dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit të siguruar është konstatuar se në lidhje me pretendimet në fjalë është duke vepruar organi tjetër kompetent - Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe ka marrë veprime në drejtim të mbledhjes së njoftimeve të nevojshme.

Nga sa u tha më lart, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm lidhur me lëndën - ku ndaj të njëjtës tashmë kanë vepruar organet tjera kompetente, dhe vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Përgatiti: A.R.M

Miratoi: NB, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Nënkryetar,  
Nuri Bajrami